



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:083681

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05706521

KF.nr.158/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit “DMN Prishtina” Sh.P.K., me seli në Prizren, cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit 48,592.28 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Senad Elshani nga avokatura “Vokshi & Lata”, e në mungesë të palës së paditur, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “DMN Prishtina” Sh.P.K., me seli në Prizren, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.18/2020, i datës 13.03.2020, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “DMN Prishtina” Sh.P.K., me seli në Prizren, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 13.07.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.18/2020 i datës 13.03.2020 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke propozuar që të aprovohet padia e paditësit, të ndryshohet vendimi i Divizionit të Ankesave në pjesën të cilat kanë të bëjnë me çështjen kontestuese të borxhit të keq dhe qarkullimit shtesë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: mbesim ne tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë së ushtruar, deklarojmë se

ekspertizën financiare e kemi pranuar dhe të njëjtën e kundërshtojmë për faktin sepse vlerësojmë se e njëjta nuk është në harmoni me provat në shkresat e lëndës për faktin se konstatimi i dhëne si në ekspertizë bie në kundërshtim me provat e paraqitura nga paditësi. Pas dëgjimit të ekspertit në këtë seance rezervojmë të drejtën për ndonjë pyetje lidhur me konstatimet e dhëna si në ekspertizë. Lidhur me çështjen e borxhit të keq sqarojmë se në periudhën e kontrollës nga ATK borxhi kontestues ka qenë i pa-mbledhshëm dhe në këto rrethana paditësi ka iniciuar procedurën e përmbarimit kundër debitorit-kompanisë “Indigo”. Me këtë vërtetohet fakti se në bazë të provave materiale të paditësit vërtetohet se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore për njohjen e borxhit të keq në kuptim të nenit 43 të Ligjit Nr.05/L-037. Lidhur me aplikimin marzhës 21 % në vlerën e shitjeve mbi marzhën e paditësit për shitjet e subjektit NTSH “Ronex” në totalin e shitjeve prej 133,828.42 Euro, nuk është asnjë arsytim as në arsyetimin e vendimit kontestues e as në ekspertizën financiare. Sipas të paditurës si bazë për përcaktimin e marzhës së përafërt përafërsisht çmimit të shitjes në tregun e hapur, pretendohet se ATK-ja ka vlerësuar çmimet e tri subjekteve “Fati” Sh.P.K., “Anex” Sh.P.K., dhe “Fari Commerce” që merren me veprimtari të ngjashme (shitjen e materialit ndërtimor) prej të cilave janë nxjerr çmimet e veglave të punës dhe marzha prej 21%. Një konstatim i tillë i të paditurës është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se këtë procedurë e paditura si palë nuk e ka paraqitur asnjë provë për t’i mbështet konstatimet e saj përkatësisht nuk e ka paraqitur asnjë faturë apo kupon fiskal lidhur me çmimin e tri kompanive të cekura që janë marr si krahasim për përcaktimin e çmimit dhe marzhës. Në rrethanat e rastit konkret rezulton se e paditura pa asnjë provë për nën deklaram të çmimit të shitjes nga paditësi, pa asnjë provë konkrete i ka rivlerësuar çmimet shitëse të deklaruar nga paditësi, dhe në këtë mënyrë ka nxjerr qarkullim të imagjinuar-hipotetik për paditësin e i cili nuk ka pasur bazë ligjore në legjislacionin tatimor të aplikueshëm dhe faktik në shkresat e lëndës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 22.07.2021, vlerëson se vendimi i DA-ATK është i bazuar në legjislacionin tatimor ndërsa padia e paditësit nuk është e bazuar dhe argumentet e parashtruara nga paditësi nuk janë të mjaftueshme për të ndryshuara njoftim ri vlerësimet e konstatuara sipas kontrollit të kryer apo për të liruar paditësin nga detyrimet konform legjislacionit tatimor. Sa i përket kontestit të borxhit të keq, ATK vlerëson se janë plotësuar kushtet pjesërisht lidhur me këtë pretendim sepse për subjektin “Hidroterm” është pranuar nga DA, për subjektin “Indigo” Sh.P.K., pjesërisht ndërsa për “A.K.” është refuzuar tërësisht fatura e borxhit të keq. Tutje shton se sa i përket deponimeve ATK konstaton se numërimi i stokut është

kryer dhe paraqitur nga paditësi dhe janë paraqitur në evidenca prandaj paditësi zbritjen e stokut është dashur ta rregulloj vet ngase kontrolli ka marr për bazë vlerën që e ka paraqitur paditësi. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 26.03.2024, ndërsa me parashtesën e datës 23.04.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veprojnë në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Me parashtesën e datës 23.04.2024 lidhur me vlerësim të ekspertizës ka theksuar se ATK si palë e paditur ka analizuar me kujdes ekspertizën e ekspertit financiar përmes të cilës ekspertizë ka dëshmuar edhe një herë vlerësimin e kontrollit tatimor nga ana e ATK-së dhe se i njëjti vlerësim është bazuar në ligje tatimore në fuqi. Argumentet e cekura vërtetojnë se vlerësimi i ATK-së është korrekt dhe i mbështetur në dispozitat ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të ia fal besimin ekspertizës financiare dhe ta fuqizoj Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së Nr.18/2020 të datës 13.03.2020. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 02.05.2024, ka administruar provat dhe atë: vendimi 18/2020 i datës 13.03.2020, ankesa e ushtruar në ATK, raporti i kontrollit nr. 14036 i datës 12.12.2019, fatura tatimore datës 28.02.2017, 25.11.2015, 30.11.2015, 13.07.2016, 15.12.2015, 13.11.2015, 26.11.2015, 31.01.2017, 21.06.2017, 02.03.2017, 29.02.2016, 21.02.2016, 30.09.2016, 04.10.2017, 05.10.2015, 06.10.2015, 23.05.2017, 31.01.2017, 20.10.2015, 29.10.2015, 31.10.2015, 28.11.2015, 24.12.2015, 28.12.2015, 26.09.2019, 24.05.2016, parashtesa PP.nr.23/16, kontrata nr.2/R e datës 18.02.2015, kartela e blerësit, aktvendimi PP.nr.23/2016, prapësimi për lëndën pa numër dhe datë, propozimi për përmbardim i datës 06.05.2016, 26.11.2015, 21.06.2017, 04.10.2017, 23.05.2017, urdhri nr.P.nr.99/2016, P.nr.19/2017, P.nr.12/2017, P.nr.73/2017, përgjigja me shkrim e komunës së Glllogocit e datës 28.10.2016, njoftimi për përmbushjen e obligimeve monetare pa numër dhe datë, marrëveshje për pagesë të obligimit e datës 14.04.2017, qarkullimi për llogarit bankare për periudhën 10.06.2017-10.07.2017, 01.05.2017-15.06.2017, 01.01.2017-30.09.2019, pagesat bankare te datës 19.10.2017, 05.06.2017, 12.10.2021, 18.12.2021, 21.10.2021, 08.11.2021, 09.11.2021, 18.11.2021, kërkesat për informata nga palët e treta, parashtesa e komunës së Prishtinës e datës 14.06.2017, parashtesa e MMPH e datës 08.12.2014, parashtesa e MPB e datës 20.06.2017, kontrata mbi marrëveshjen për bashkëpunim dhe kompensim e datës 31.12.2015, procesi mbi vërtetimin. Barazimin e kartelave financiare datës 14.04.2017, parashtesa – anulimi i kontratës

datës 30.06.2020, kartela e furnitorit, note debiti e datës 06/2020, përgjigja ne padi 22.07.2021, fletat e punës te ATK-ës, njoftimet për rivlerësim, dhe ekspertiza financiare e datës 05.03.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve të padi, shkresat e lëndë aktvendimit kontestues dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të Raportit të kontrollit ka parashtruar ankesë, pran Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 15.01.2020, për të cilën ankesë ATK me datë 13.03.2020 ka sjell vendimin nr.18/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin vendim ka aprovuar pjesërisht ankesën nr.18/2020 të datës 15.01.2020 të paditurit, dhe ka ndryshuar njoftim vlerësimet e tatimit shtesë për periudhat 01, 02.2017 në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatim në Korporata periudha 2017, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit ka mbetur e pa ndryshuar, sipas vlerësimit të kontrollit, e kundër të cilit akt paditësi me këtë padi, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.158/22 të datës 30.01.2024 ka caktuar ekspertizë financiare, përmes të cilës e ka obliguar ekspertin financiar Gëzim Pajaziti që të konstatoj dhe vlerësoj detyrat si në këtë aktvendim.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 29.02.2024 dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 02.05.2024, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *Nuk janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen dhe pranimin e borxhit të keq në shumë total me TVSH 48,598.28 €. Marzha prej 21% në vlerën e shitjeve mbi marzhën e paditësit për shitjet subjektivit NTSH "Ronex" në totalin e shitjeve prej 133,828.42€ është aplikuar saktë dhe drejtë. Aplikimi i*

metodës së hapur të tregut për shitjet e realizuara është bërë kur Kontrolli i ATK-së tek të dhënat e paditësi ka evidentuar transaksione me palë të lidhur, gjegjësisht transaksione të paditësit DMN Prishtina me subjektin NTSH “Ronex” pronar i së cilave është person i njëjtë. Qarkullimi shtesë në shumën prej 27,840.42 €, mbi të cilin janë kalkuluar detyrime tatimore ndaj paditësit është konstatuar saktë dhe konform Ligjit 03-222 neni 46 Paragrafi 2.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 05.03.2024 të ekspertit Gëzim Pajaziti në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 02.05.2024 ka deklaruar se: mbes në tërësi pranë ekspertizës financiare të punuar në këtë lende. Jam i gatshëm për sqarime shtese nëse ka pyetje. Unë kam konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen dhe pranimin e borxhit të keq në këtë vlerë, meqenëse sipas dëshmimeve në dosjen e lëndës, divizioni i ankesave i ATK-ës, për sa i përket debitorit “Indigo” SHPK, ka pranuar si borxh të keq vetëm vlerën prej 13.640.53 €, për shkak se edhe në dosjen e lëndës janë evidentuar vetëm tri pagesa të cilat “Indigo” SHPK i ka ekzekutuar për këtu paditësin në vlerë prej 15.000.00 €, si dhe vlerën e një banesë nga “Indigo” Sh.P.K., në emër të borxhit në vlere prej 32.000.00 €. DA i ATK-ës nuk i ka marre parasysh vlerën banesës dhe të këtyre pagesave shtese, ndërsa pjesën tjetër e ka njohur si borxh të keq. ATK është bazuar në kontratën që e kanë lidhur palët sa i përket banesës.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, me vendimin kontestues nr.18/2020 të datës 13.03.2020 e ka aprovuar pjesërisht ankesën nr.18/2020 të datës 15.01.2020 të paditurit, dhe ka ndryshuar njoftim vlerësimet e tatimit shtesë për periudhat 01, 02.2017 në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatim në Korporata periudha 2017, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit ka mbetur e pa ndryshuar, sipas vlerësimit të kontrollit, me arsyetim se Departamenti i Ankesave konstaton se këtë vendosje e ka mbështet në nenin 14, 15 dhe nenit 19 të Ligjit Nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore të Kosovës dhe Procedurat ku paragrafi 2 i nenit 19 të Ligjit 03/L-222 mbi ATK parasheh: *Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose të saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion , përfshirë: librat, regjistrimet, kuponët , faturat ose informata tjera përkatëse të tatimpaguesit, librat, regjistrimet, kuponët , faturat ose informata tjera përkatëse të personave të tretë , informata nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit, informata të tjera objektive*

rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatim paguesit lidhur me detyrimin e tij, informatat e siguruar gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 14 të këtij ligji, aplikimin e këtij ligji dhe/apo ligjet e aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSH në Kosovë. Tutje cek se Divizioni i Ankesave vlerëson se vlera e faturave të pranuar të borxhit të keq i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore për pranim të TVSH-së së zbritshëm sipas neneve të Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuat dhe vendos të ndryshoj Njoftim Rivlerësimet e TVSH-së për periudhat tatimore Janar/2017 për vlerën 13, 640.54€ dhe Shkurt/2017 për vlerën 9, 275.42€.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se nuk është i bazuar dhe i drejtë arsyetimi i të paditurës për debitorin “Indigo” se e ka njohur si borxh të keq vetëm vlerën e tatueshme prej 13,589.28 € nga totali i vlerës së tatueshme prej 41,187.74 € , kjo për arsye se Divizioni i Ankesave ka vepruar drejtë kur e ka pranuar pjesërisht këtë borxh të keq në vlerë prej 13,640.54 € për shkak se subjekti “DMN-Prishtina” ka marr një banesë në emër të borxhit në vlerë prej 32,000.00 € me datë 31.12.2017 ka bërë pagesë prej 2,000.00 €, me datë 17.05.2017 në vlerë 10,000.00 € dhe me datë 29.06.2019 në vlerë 3,000.00 €, që do të thotë se tatimpaguesi ka pranuar detyrimin prej 47,009.00 € prej “Indigo” Sh.P.K., të vërtetuar nga përllogaritja e inspektorit në fletat e punës, duke u bazuar në llogarit bankare dhe kontratën e subjektit “Indigo”, prandaj nga këto prova materiale departamenti ka pranuar vetëm vlerën prej 13,589.28 € si borxh të keq në TVSH-ë periudhën 01/2017, e jo vlerën që konteston tatimpaguesi prej 60,5987.28 €. Po ashtu DA ka vepruar drejtë kur nuk i ka pranuar as faturat e borxhit të keq në vlerë prej 22, 000.00€ për debitorin A.K. nga Drensi, pasi T/p pasi nuk i ka plotësuar kriteret të parapara me nenin 43 të Ligjit nr.03/L-037 për TVSH-ë.

Gjykata e ka vlerësuar edhe pretendimin e paditësit lidhur me aplikimin e marzhës prej 21% dhe se paditësi ka lëshuar të gjitha fatura me të gjitha elemente konform nenit 45 ose 46 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH, por ka gjetur se ky pretendim nuk është i bazuar sepse sipas Raportit të Kontrollit të ATK-së dhe dokumenteve financiare totali i shitjeve “DMN Prishtina” ndaj subjektit “NTSH Ronex” për vitin 2017 është 133,828.42 €. Pasi që është vërtetuar se pronar i këtyre dy subjekteve “DMN Prishtina” dhe “NTSH “Ronex” është personi i njëjtë , Kontrolli i ATK-së në përputhje me Ligji nr.03.L-222 neni 4 paragrafi 2 për transaksionet në mes të këtyre dy subjekteve i ka caktuar të ardhura shtesë subjektit “DMN Prishtina” për të reflektuar të ardhura të tatueshme të cilat do të kishin rezultuar nga transaksioni nëse personat do të ishin të lidhur. Si bazë për përcaktimin e përafërt të marzhës, përkatësisht çmimit të shitjes në tregun e

hapur, janë vlerësuar çmimet nga të tri subjekte “Fati” Sh.P.K., “Anex” Sh.P.K., dhe “Fari Commerce” pasi që merren me veprimtari të ngjashme (shitje e materialeve ndërtimore) prej të cilave janë nxjerrë çmimet e veglave të punës dhe marzha mesatare prej 21 %. Andaj është vërtetuar se paditësi ka shitur vegla të punës tek “NTSH Ronex” në vlerë prej 45,083.54 € prej totalit 133, 828.42 € nën çmimin kushtetues, prandaj ATK, ka shtuar diferencën dhe ka bërë përlllogaritjen e marzhës prej 21% (ka evidentuar qarkullim shtesë prej 13,640.54 €. Nga kjo shihet se marzha prej 21% në vlerën e shitjeve mbi marzhën e paditësit për shitjet subjektit NTSH “Ronex” në totalin e shitjeve prej 133, 828. 42 është aplikuar saktë dhe drejtë.

Duke mare për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se vendimi nr.18/2020, i datës 13.03.2020 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.158/22 datë 02.05.2024

Zyrtare Ligjore

Amire JAHIRI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.